



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 15.5.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj Bilall Sherifi, Nezir Çoçaj.

Munguan: Hajdar Beqa, Glauk Konjufca dhe Igor Simiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shaban Murturi, EUSR; Kosovare Gashi, Radio Kosova, Fitore Sopjani, praktikante, Kuvendi i Kosovës; Aldisa Morina, asistente, AAK; Gëzim Shala IND/BPD, Valbona Bytyçi “Ekonomia online”; Rreze Hoxha, GLPS; Edita Kusari, Blerta Bejtullahu, EUSR; Enis Halimi, Valdete Daka, KQZ; Albert Krasniqi, NDI.

Mbledhjen e kryesoi Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 10.4. dhe 16.4.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2017;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-030 për aktet juridike;
5. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
6. Kërkesa e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për dorëzimin e Raportit vjetor dhe financiar për vitin 2017, pa aprovim të Bordit Mbikëqyrës;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit te ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 10.4. dhe 16.4.2018

Kryetarja konstatoi se u miratuan procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datë 10.4. dhe 16.4.2018.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2017

Kryetarja, tha se raporti që ka ardhur nga KQZ nuk është miratuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për këtë arsye, ajo kërkoi nga kryetarja e KQZ-së, znj. Valdete Daka, të sqarojë para komisionit, pse nuk është miratuar ky raport nga KQZ?

Valdete Daka, tha se raporti nuk është miratuar nga KQZ, sepse përbërja e vjetër që ka pasur ky komision, nuk ka mandat, megjithatë pas diskutimeve që komisioni kishte, është vendosur që ky raport me apo pa miratim të dërgohet në Kuvend dhe nuk mendoj që është problem, sepse po i njëjti është i publikuar edhe në ueb-faqe të KQZ-së, theksoi znj. Daka.

Bilall Sherifi, parashtrioi pyetje për znj. Daka: Pse nuk është miratuar raporti nga i njëjti komision zgjedhor, kur po të njëjtit anëtarë të komisionit kanë qenë në proces të kryerjes së këtij raporti?

Sami Kurteshi, tha se anëtarëve iu pushon mandati, pa të drejtë edhe veprimi funksional apo ju pushon krejt mandati. Cila është arsyeja që është krijuar kjo situatë?

Albulena Haxhiu, sqaroi se kur dikush nuk ka mandat, çfarëdo vendimi që merr është i paligjshëm. Meqë kishte paqartësi, deputetja Albulena Haxhiu kërkoi sqarim nga znj. Daka rreth kësaj çështjeje.

Valdete Daka, tha se nuk ka kompetencë të bëjë interpretim të Kushtetutes as të ligjit, sidomos për këto çështje dhe as për grupe parlamentare. Vendimet e antarëve të KQZ-së, të cilëve iu ka skaduar mandati nuk mendoj që duhet të jenë të ligjshme. Është konsideruar që do të jetë më mirë që raporti të dërgohet në Kuvend, edhe pa miratim, sesa të mos dërgohet fare, tha mes tjerash znj. Daka. Më tej, ajo tha se ky raport reflekton të gjitha punët që institucioni i KQZ-së ka bërë gjatë vitit. Në vitin 2017, KQZ është përballuar me disa sfida, të cilat nuk i kishim në zgjedhjet e kaluara, është fjala për decertifikimin e disa kandidatëve, si dhe çështja tjetër ishte ajo e kandidatëve të komuniteteve jo shumicë, ku në listat e tyre janë gjetur kandidatë, të cilët kanë përfaqësuar shumicën shqiptare. Pra, vetë fakti që kemi pasur zgjedhje për tridhjetë ditë, është sfidë, tha mes tjerash znj. Valdete Daka.

Ajo përmendi si sfidë edhe votimin jashtë Kosovës dhe tha se ky votim ka shkaktuar shumë probleme. KQZ është akuzuar padrejtësisht nga të gjithë në këto zgjedhje, por ne vetëm e kemi zbatuar ligjin, ashtu siç është, duke rekomanduar që sa më parë të ketë reformë zgjedhore. Kjo është kërkesë edhe e vëzhgueseve lokalë dhe ndërkombëtarë, në mënyrë që të rregullohen

çështjet që kanë të bëjnë, sidomos me votimin jashtë Kosovës. Sa i përket zgjedhjeve lokale, ajo tha se ka pasur komoditet më të madh, por prapë është dashur që të bëhet rinumërimi i kutive, për shkak të votave të kandidatëve për asamble. Pra, përderisa nuk rregullohet me ligj kjo çështje, gjithmonë do të ketë vonesë të rezultateve, për shkak të fletëvotimit, theksoi znj. Daka. Sfidë tjetër, tha se është edhe Mitrovica veriore, me kandidatët nga subjektet e komuniteteve jo shumicë. Mes tjerash, znj. Daka, përveç sfidave, tha se KQZ ka edhe suksese, duke qenë fituese e një çmimi ndërkombëtar për organizim të zgjedhjeve. Çështja e pagesës së komisionarëve është një tjetër problem, pastaj sfidë është dështimi i informimit publik, për shkak të procedurave të zgjatura të tenderimit.

Kryetarja, tha se nga vëzhguesit vendorë, por edhe nga ata ndërkombëtarë, është thënë se zgjedhjet e fundit kanë qenë zgjedhje kryesisht të qeta dhe të rregullta, megjithatë, janë evidentuar edhe një sërë parregullsish, sidomos në ditën e votimit. Ajo tha se kishte kritika për sa i përket funksionalizimit apo mos funksionalizimit të KQZ-së e këto kritika janë për Presidentin aktual të shtetit, për arsye se është pa precedent që dy muaj me radhë e ndoshta edhe më shumë, KQZ të mbetet jofunksionale. Sa i përket votimit jashtë vendit është, e vërtetë që ka probleme. Deputetja Haxhiu tha se mënyra më e mirë do të ishte t’iu jipet mundësia mërgimtarëve që të shfrytëzojnë të drejtën e votës nëpër ambasada apo nëpër konsullata dhe jo t’i ngarkojmë me këto procedura të vështira.

Pyetjet për kryetaren e KQZ-së nga deputetja Haxhiu, kishin të bënin kryesisht me numrin e madh të fletëvotime të pavlefshme, po ashtu përqindja e votimit me asistencë, pastaj mospastrimi i listës së votuesve. Problem tjetër, tha se është lejimi për sjelljen e aplikacioneve të fletëvotimeve nga Serbia. Ndërsa, sa i përket reformës zgjedhore, ajo tha se është hapur si diskutim tash së voni, edhe pas përpjekjeve dy-tri vjeçare, në mungesë të vullnetit politik, nuk është realizuar.

Sami Kurteshi, kishte disa pyetje për kryetaren e KQZ-së. Pyetja e parë kishte të bënte me pasojat që mund të vijnë për shkak të mosvotimit të raportit nga KQZ-ja. Pyetja tjetër kishte të bënte me reformën zgjedhore dhe mënyrën sesi të ndihmohet që votimi nga jashtë të jetë më i lehtë, pra cilat ndryshime duhet bërë? Çështja tjetër është për problemet që ju i keni me prokurimin me Ministrinë e Financave. A e keni hapur këtë, së paku me ndonjë letër në Kuvend, pra për mjetet që i tërheq Ministria e Financave?

Bahrim Shabani, pyetja e drejtuar për znj. Daka kishte të bënte me emrat e shqiptarëve në listat e subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Cilët janë hapat që po ndërmerr KQZ për të eliminuar këtë problem?

Korab Sejdiu, sa i përket çështjes së vjedhjes së votave brenda listave, mendoj që ka një mbikëqyrje jashtëzakonisht të mirë dhe është eliminuar deri diku problemi i vjedhjes industriale që ka qenë në të kaluarën ndërmjet partive politike, por nuk është eliminuar vjedhja industriale brenda listave. A e keni identifikuar si problem shumë serioz, sepse po e shpërfiton përfaqësimin e qytetarëve në Kuvend, duke dërguar deputetë që jo domosdoshmërisht ishte dashur të jenë aty dhe duke lënë jashtë ata që ishte dashur të jenë?

Valdete Daka, sa i përket pyetjes së z. Shabani, KQZ është përballur për herë të parë me këtë problem, pra me gjetjen e emrave të shqiptarëve në listat e subjekteve politike që përfaqësojnë

komunitetet jo shumicë dhe të cilat garojnë për vendet e garantuara me Kushtetutë. Kjo ka ndodhur, sepse rastësisht është zbuluar që ata nuk janë boshnjakë. Aty, fajin e bartë vetë subjekti i cili ka dërguar ata emra, tha znj. Daka.

Enis Halimi, tha se sa i përket votimit jashtë vendit, është një proces i vështirë. KQZ, pas çdo procesi zgjedhor, bën analizë të shkaqeve që kanë të bëjnë me rezultatet e zgjedhjeve. Sa i përket votimit me asistencë, është procedurë e paraparë me ligj dhe është përgjegjësi e këshillit të vendvotimit që ta zbatojë ashtu parashihet.

Sa i takon manipulimit të votave brenda listës, KQZ ka bërë skanimin e formularëve, të cilët janë publikuar pastaj, në mënyrë që të jenë më lehtë të qasshëm për publikun, pastaj është bërë edhe rihapja e kutive theksoi z. Halimi.

Sami Kurteshi, pyeti: Cilat janë problemet që dërgohen me aq vonesë fletëvotimet jashtë vendit?

Valdete Daka, sqaroi se është një procedurë që duhet të ndiqet dhe koha e shkurtër për organizim të zgjedhjeve ka krijuar edhe vonesa.

Arben Gashi, tha se raporti nuk ka bazë juridike të procedohet në Kuvend, derisa të plotësohen kushtet formale juridike.

Pas diskutimeve, komisioni vendosi që mos të procedohet Raporti i KQZ-së për vitin 2017, pasi që i njëjti nuk i është nënshtruar votimit nga KQZ.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-030 për aktet juridike

Kryetarja, tha se Komisioni për Legjislacion ka formuar një grup punues të drejtuar nga z. Hajdar Beqa, ku është analizuar ky projektligj. Pas hulumtimit që kemi nga zyra ligjore dhe nga stafi i komisionit, është vlerësuar që ky projektligj të mos përkrahet, për shkak se ka probleme kushtetuese. Prandaj, duhet rekomanduar seancës plenare që të mos miratohet ky projektligj, tha deputetja Albulena Haxhiu.

Pas diskutimeve, komisioni, njëzëri, nxori këtë

R e k o m a n d i m

Të mos miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-030 për aktet juridike.

5. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve

V e n d i m

Për formimin e grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

1. Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor, me këtë përbërje:
 1. Sami Kurteshi, kryetar,
 2. Hajdar Beqa, anëtar,
 3. Korab Sejdiu, anëtar,
 4. Albulena Haxhiu, anëtare,
 4. Bahrim Shabanaj, anëtar.

2. Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me këtë përbërje:
 1. Hajdar Beqa, kryesues,
 2. Albulena Haxhiu, anëtare,
 3. Korab Sejdiu, anëtar,
 4. Shkumbin Demaliaj, anëtar,
 5. Bahrim Shabani, anëtar,
 6. Sami Kurteshi, anëtar.

3. Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me këtë përbërje:
 1. Albulena Haxhiu, kryesuese,
 2. Hajdar Beqa, anëtar,
 3. Korab Sejdiu, anëtar,
 4. Shkumbin Demaliaj, anëtar,
 5. Bahrim Shabani, anëtar,
 6. Sami Kurteshi, anëtar.

6. **Kërkesa e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për dorëzimin e Raportit vjetor dhe financiar për vitin 2017, pa aprovim të Bordit Mbikëqyrës**

Kryetarja, tha se sa i përket kësaj pike, përgjigjen e ka të njëjtë, si më parë, sepse bordi i kësaj agjencie është jofunksional dhe si i tillë nuk mund të shqyrtohet.

7. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit për takimin me përfaqësuesen e Komisionit Evropian, znj. Apostolova, ku tha se kanë diskutuar për shqyrtimin dhe procedimin e Kodit Penal. Po ashtu, kryetarja tha se kërkesë është që Kodi Penal, në shqyrtim të dytë, të miratohet deri në fund të qershorit. Në vazhdim, kryetarja e komisionit njoftoi anëtarët e komisionit edhe për takimin që kryetarët e komisioneve kanë pasur me kryetarin e Kuvendit, ku tha se për komisionin ka marrë kritika që nuk po shqyrton projektligjet në afatet kohore. Znj. Haxhiu shtoi duke thënë se Komisioni për Legjislacion është shumë i ngarkuar me Projektligje dhe nuk janë aspak të drejta kritikrat që adresohen për komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 13:43.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu